



Thirrje për Aplikim në Seminaret e ofruara nga ERA

Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se Akademia e Drejtësisë Kosovës në kuadër të bashkëpunimit me Akademinë e së Drejtës Evropiane (ERA), po e ndanë me ju njoftimin e ERA's për mundësitë ndjekjes së dy Serive të Seminareve për vitin 2025.

Të dy seritë e seminareve janë plotësisht të financuara nga Komisioni Evropian dhe janë të hapura për gjyqtarët dhe prokurorët evropian dhe ata nga Kosova.

SEMINARET MBI TË DREJTËN E BE-SË KUNDËR DISKRIMINIMIT:

Kjo seri seminaresh ka të bëjë me direktivat e BE-së kundër diskriminimit 2000/78 dhe 2000/43 (që mbulojnë diskriminimin në bazë të racës, moshës, aftësisë së kufizuar, fesë dhe orientimit seksual).

Vendi – Data – Gjuha:

- Upsala, 7-8 prill 2025, gjuha angleze – afati fundit për aplikim: 12 shkurt 2025
 - Krakovë, 1-2 shtator 2025, Anglisht/Polonisht – afati fundit për aplikim: 2 korrik 2025
 - Trier, 12-14 nëntor 2025, anglisht/gjuhë boshnjake – kroate – serbe – afati fundit për aplikim: 21 shtator 2025
- (Ju lutem vini re se programi përfshinë edhe një vizitë në CJEU në Luksemburg me datë 13 Nëntor)

Kushtet e financimit

Për të gjitha këto seminare, ERA mund të rimbursojë pjesëmarrësit deri në 450 EUR të kostos së udhëtimit, ndërsa do të mbulohen drejtpërdrejt 2 netë akomodimi.

Për më shumë informata rreth seminareve kliko në linkun: www.era.int/anti-discrimination.

SEMINARET MBI TË DREJTËN E BE-SË PËR BARAZINË GJINORE:

Kjo seri seminaresh i kushtohet ligjit të BE-së për barazinë midis grave dhe burrave.

Vendi – Data – Gjuha:

- Bruksel, 24-25 mars 2025, anglisht/frëngjisht – afati i fundit për aplikim: 29 janar 2025
- Limassol, 8-9 maj 2025, anglisht/greqisht – afati fundit për aplikim: 16 mars 2025
- Beograd, 27-28 tetor 2025, anglisht/serbisht – afati fundit për aplikim: 3 shtator 2025

Kushtet e financimit

Për të gjitha këto seminare, ERA mund të rimbursojë pjesëmarrësit deri në 450 EUR të kostos së udhëtimit, ndërsa do të mbulohen drejtpërdrejt 2 netë akomodimi.

Për më shumë informata rreth seminareve kliko në linkun: www.era.int/gender.

Vërejtje: Të interesuarit për ndjekjen e seminareve mund të kontaktoni:

Linda Fejzullahu,
Zyrtare e Lartë për Komunikim dhe Bashkëpunim
Email adresa: linda.fejzullahu@rks-gov.net
Nr. Zyre: 038 200 18 676
Tel: +383/44-177-588